

Çmimet e ulëta të cigareve rrisin gjasat që të rinjtë të fillojnë duhanpirjen

Gjetjet kryesore:



Në vitin 2016, duhanpirja te të rinjtë (13–15 vjeç) në Kosovë ishte rreth 9 për qind (11.7 për qind për djemtë dhe 5.6 për qind për vajzat).



Një rritje e çmimit prej 10 për qind do të rriste çmimin mesatar të një pakoje cigaresh prej 2.2 euro për 0.22 euro, duke ulur kështu rrezikun e duhanpirjes nga të rinjtë për 14.3 për qind.



Qasja e lehtë në blerjen e cigareve rrit gjasat që të rinjtë të fillojnë duhanpirjen.




Prindërit dhe bashkëmoshatarët duhanpirës kanë ndikim të konsiderueshëm në fillimin e duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë.

Informata të përgjithshme

Duke pasur parasysh se fillimi i konsumit të duhanit kryesisht ndodh gjatë moshës së adoleshencës, për Kosovën, si shteti me popullsinë më të re në Evropë, është thelbësore që të identifikohen faktorët shtytës prapa fillimit të duhanpirjes.

Gati 50 për qind e popullsisë së Kosovës është nën moshën 25 vjeçe dhe rinia e saj, ndonëse konsiderohet si një nga pasuritë më të mëdha të vendit, mund të bëhet thembër e Akilit nëse të rinjtë nuk janë të shëndetshëm dhe produktivë si pasojë e konsumimit të duhanit. Më 2016, të rinjtë (mosha 13-15) në Kosovë raportuan shkallë të duhanpirjes prej rreth 9 përlind, me 11.7 për qind për djemtë dhe 5.6 për qind për vajzat (Figura 1).

Figura 1
Konsumuesit aktualë të duhanit te të rinjtë e moshës 13-15 vjeç




Burimi: GYTS, 2016

Figura 2 dhe 3 tregojnë mungesën e zbatimit të ligjit për sa i përket shitjes së cigareve: më shumë se 60 për qind e të rinjve arrijnë të blejnë cigare në pikat legale të shitjes, edhe pse nuk ishin të moshës madhore për t'i blerë ato.

Figura 2


Të rinj duhanpirës që kanë blerë cigare në pika ligjore të shitjes



Burimi: GYTS, 2016

Figura 3

Të rinjtë duhanpirës lejohen të blejnë cigare përkundër moshës së tyre




Burimi: GYTS, 2016

Fillimi i duhanpirjes te të rinjtë është shqetësim serioz për shëndetin publik. Duhanpirja në moshë të re rrit gjasat që një person të vazhdojë të pijë duhan edhe në moshën madhore, duke shkaktuar probleme shëndetësore afatgjata. Më shumë se gjysma e duhanpirësve vdesin para kohe nga përdorimi i duhanit. Prandaj, është me rëndësi që prindërit, edukatorët dhe politikëbërësit të ndërmarrin hapa për të parandaluar që të rinjtë të fillojnë duhanpirjen dhe t'i ndihmojnë të rinjtë të shmangin rreziqet e përdorimit të duhanit.

Figura 4

Të rinjtë janë të ekspozuar ndaj kujtudo që konsumon duhan në televizion, video, apo filma



Burimi: GYTS, 2016

Ekziston një numër i konsiderueshëm hulumtimesh mbi fillimin e duhanpirjes te të rinjtë (mosha kur individët fillojnë të pinë duhan për herë të parë) dhe mbi faktorët e identifikuar si kontribuues për fillimin e duhanpirjes te të rinjtë, si ndikimi i bashkëmoshatarëve, faktorët socio-ekonomikë, ndikimi i familjes dhe ekspozimi në marketingun e duhanit.

Rezultatet

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se moshë mesatare e fillimit të duhanpirjes te të rinjtë në Kosovë është 11 vjeç. Nga personat që kanë filluar duhanpirjen në mostrën përfaqësuese në nivel shtetëror, 61 për qind janë meshkuj dhe 38 për qind janë femra. Në veçanti, një përqindje e vogël (tre për qind) filluan të pinë duhan në moshën tetë vjeçe, ndërsa rreth 12 për qind filluan në moshën 15 vjeçe.

Sipas hulumtimit, çmimet luajnë rol kyç për fillimin e duhanpirjes te të rinjtë e Kosovës. Një rritje e çmimit prej 10 për qind do të rriste çmimin mesatar të një pakoje cigaresh prej 2.2 euro për 0.22 euro, gjë që do të rezultonte në ulje të rrezikut që të rinjtë të nisin duhanpirjen për 14.3 për qind.

Çmimi është përcaktues veçanërisht i fortë për duhanpirëset e reja në Kosovë, të cilat shfaqin rënie prej 85 për qind në rrezikun e pritshëm të fillimit të

duhanpirjes për çdo rritje të çmimit prej një për qind. Por, për meshkujt e rinj, çmimi nuk paraqitet si faktor i rëndësishëm në përcaktimin e nisjes së duhanpirjes.

Mjedisi social gjithashtu duket të jetë faktor i rëndësishëm në sjelljen e duhanpirjes së të rinjve në Kosovë. Ka një rritje prej 129 për qind të rrezikut të pritshëm nëse gjysma e shokëve të një të riu konsumojnë duhan, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante.

Qasja në blerjen e cigareve është një tjetër përcaktues i rëndësishëm i sjelljes së duhanpirjes te të rinjtë e Kosovës. Qasja e lehtë duket se rrit rrezikun e fillimit të duhanpirjes. Rezultatet sugjerojnë se rreziku i pritshëm i fillimit të duhanpirjes është 286 për qind më i lartë për të anketuarit të cilët e kanë mjaft të lehtë blerjen e cigareve, duke mbajtur çdo gjë tjetër konstante.

Rekomandimet e politikave

Rritja e çmimit të produkteve të duhanit përmes akcizës. Siç tregon ky studim, rritja e çmimeve mund të jetë një parandalim efektiv për të rinjtë: një rritje prej 10 për qind do të rriste çmimin mesatar të një pakoje cigaresh prej 2.2 euro për 0.22 euro, gjë që do të rezultonte në ulje të rrezikut që të rinjtë të nisin duhanpirjen për 14.3 për qind.

Pikat e shitjes duhet të inspektohen më shpesh për të zbatuar masat e verifikimit të moshës në pika të shitjes dhe për të parandaluar qasjen e lehtë të të rinjve në produkte të duhanit.

Të realizohen programe edukative me fokus te të rinjtë—programe gjithëpërfshirëse, të bazuara në fakte për rreziqet e duhanpirjes—të hartuar enkas për parandalimin e fillimit të duhanpirjes nga të rinjtë.

Të iniciohen fushata mediale që synojnë prindërit në mënyrë që rritet ndërgjegjësimi për efektet e dëmshme të konsumit të duhanit te fëmijët e tyre dhe ndikimit të mundshëm që sjellja e tyre mund të ketë në vendimet e fëmijës për t'u bërë duhanpirës.

Mirënjohje:

Demokrasi Plus financohet nga Instituti për Kërkime dhe Politika Shëndetësore (UIC) i Universitetit të Illinois në Çikago për realizimin e hulumtimeve ekonomike mbi tatimin e duhanit në Kosovë. UIC është partner i Iniciativës së Filantropisë Bloomberg për reduktimin e konsumit të duhanit. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk mund t'i atribuohen dhe nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë pikëpamjet e UIC, Institutit për Kërkime dhe Politika Shëndetësore, ose Filantropisë Bloomberg.

Policy Recommendations

Increase the price of tobacco products through excise taxes. As this study shows, price increases can be an effective deterrent for youth: just a one-percent increase in price results in a 65-percent decrease in the expected hazard of smoking initiation.

Points of sale need to be more frequently inspected to enforce age verification measures at the point of sale and prevent youths from easy access to tobacco products.

Provide youth-focused education programs—comprehensive, evidence-based programs about the dangers of smoking—designed to deter youth from starting to smoke.

Implement mass media campaigns targeting parents to raise awareness about the detrimental effects of tobacco consumption on their children and the potential influence their behavior may have on their children's decisions to become smokers.

Acknowledgments:

Democracy Plus is funded by the University of Illinois Chicago's (UIC) Institute for Health Research and Policy to conduct economic research on tobacco taxation in Kosovo. UIC is a partner of the Bloomberg Philanthropies' Initiative to Reduce Tobacco Use. The views expressed in this document cannot be attributed to, nor can they be considered to represent, the views of UIC, the Institute for Health Research and Policy, or Bloomberg Philanthropies.